



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr.____, datë _____, 2025

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 425, DATË 26.6.2024, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË
NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE MËSIMORË DHE TË
PUNONJËSVE TË TJERË JOMËSIMORË NË INSTITUCIONET ARSIMORE
DHE NË INSTITUCIONET PLOTËSUESE TË SISTEMIT ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR”**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, të ndryshuar, dhe të neneve 37, pika 5, e 59, pika 3, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhjet nr.1, nr. 2 e nr. 3, të vendimit nr. 425, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar”, zëvendësohen me lidhjet me të njëjtët numra dhe emërtime, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Vlerat e elementit “paga e pozicionit”, për:

a) pozicionet me numër rendor 1 deri në 6, të lidhjes nr. 1, pozicionet me numër rendor 1 dhe 2, të lidhjes nr. 2 dhe pozicionet me numër rendor 1 deri në 4, të lidhjes nr. 3, janë rezultat i indeksimit në masën 2.5% dhe politikës së rritjes së pagave;

b) pozicionet e tjera, janë rezultat i indeksimit në masën 2.5%.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2026, të përballohen nga buxheti i institucioneve përkatëse, të miratuara në ligjin 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026". Për njësitë e vetëqeverisjes vendore, përballohen nga transferta e miratuar në ligjin 87/2025. "Për buxhetin e vitit 2026", si dhe nga të ardhurat e veta të njësive të vetëqeverisjes vendore.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2026.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA